

VENDIM
Nr.57, datë 7.2.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 3575 M²,
PJESË E PRONËS NR.177 “ISH-BATALION TANKESH”, SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 3575 m², pjesë, truall, e pronës nr.177 “Ish-batalion tankesh” Sauk, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, për ngritjen e nënstacionit të ri 110/20 kw, për fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar.

2. Sipërfaqja 3575 m², pjesë, truall, e pronës nr.177 “Ish-batalion tankesh”, Sauk, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, si dhe ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtori i Përgjithshëm i KESH-it dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

KOMUNA FARKË, TIRANË										
A			B				C			
Nr.	Zona kadastrale Indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës/vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose Ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
177			Ish-batalioni i tankeve			23446 m ²	Për mbrojtjen	MM Rep. Usht. 8800 Tiranë	Reparti 8880 Tiranë	
			Sauk, Tiranë	Fjetinë, mencë, kuzhinë	Sauk, Tiranë	216				Dhënë Ministrisë së Arsimit në huapërdorje
				Depo		212				Proces privatizimi
				Depo		230				"
				Truprojë		50				"
				Banjë WC		76				"
				Truall		22662				"
				Strehim tanku		Copë 4				

